**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
N/Br. 696-697/20
Data 21.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

**PSH. nr. 696/20**
**697/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: "Pro Medical & Andident"- Ferizaj , kundër Lotit 1 dhe Lotit 2, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë në Lotin 1, OE: "Arben S. Ismajli B.I "- Prishtinë, dhe për Lotin 2 OE: N.SH "El Dental"- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje mjekësore për DSHB për Lotin 1 Pajisje Stomatologjike, dhe për Lotin 2, Karrika Gjinekologjike", me nr. të prok: 206-20-2953-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Shëndetësisë" (M.SH), më datën: 21.10.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I.<u>APROVOHEN</u>**, si pjesërisht të bazuara ankesat e grupit të operatorëve ekonomik: "Pro Medical & Andident"- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje mjekësore për DSHB për Lotin 1 Pajisje Stomatologjike, dhe për Lotin 2, Karrika Gjinekologjike", me nr. të prok: 206-20-2953-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Shëndetësisë" (M.SH).

**<u>II.ANULOHET,</u>** njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje mjekësore për DSHB për Lotin 1 Pajisje Stomatologjike, dhe për Lotin 2, Karrika Gjinekologjike", me nr. të prok: 206-20-2953-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Shëndetësisë" (M.SH), dhe lënda të kthehet në **rivlerësim.**

**III**. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesat grupit të operatorëve ekonomik ankues: "Pro Medical & Andident"- Ferizaj, i aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI .**Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: "Pro Medical & Andident"- Ferizaj , si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 31.09.2020 me nr. 696/20, dhe me 21.09.2020 me nr. 697/20 , kundër Lotit 1 dhe Lotit 2, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë në Lotin 1, OE: "Arben S. Ismajli B.I "- Prishtinë, dhe për Lotin 2 OE N.SH "El Dental"- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje mjekësore për DSHB për Lotin 1 Pajisje Stomatologjike dhe për Lotin 2, Karrika Gjinekologjike", me nr. të prok: 206-20-2953-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Shëndetësisë" (M.SH), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60,71, si dhe nenin 108/A. parag. 6 i LPP-së, te ankesa me nr. 696/20 për Lot 1.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60,71 , si dhe nenin 108/A. parag. 6 i LPP-së, te ankesa me nr. 697/20, për Lot 2.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 05.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Pro Medical & Andident"-Ferizaj

**Sqarim hyrës:** Autoriteti Kontraktues/ MSH, gjate këtij aktiviteti te prokurimin ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kane te bëjnë kundër arsyetimit te eliminimit ku AK – MSH, përmes letrës standarde te datës 07.09.2020, tekstualisht ka potencuar: "...*OE* "Pro Medical" SH.P.K, është i pa përgjegjshëm, njeri nga anëtaret grupit nuk ka licencën qe është kërkuar "Licenca nga AKPPM, si qarkullues me shumicë i pajisjeve mjekësore".

Parashtruesi i ankesës me datën 14.09.2020, ka paraqitur kërkese për ri shqyrtim duke kontestuar eliminimin mirëpo sipas shkresave te lendes AK/MSH, rezulton qe ne nuk kemi hasur diku qe te njëjtit i janë përgjigjur kërkesës për ri shqyrtim. Sipas nenit 108/A, te LPP-se shqyrtimi i kërkesës është i obligueshëm nga AK (shiko par 6, te nenit 108/A, te LPP-se).

**Sqarim i pretendimeve ankimore (Neni 113 LPP)** Sa i përket arsyetimit te eliminimit" ...anëtari i grupit nuk ka prezantuar licence nga AKPPM...", vlerësojmë se si i tille bie ndesh me praktiken dhe rregullat për prokurim publik, përkatësisht me nenin. 71, te LPP-se, pasi qe AK, te njëjtën licence e ka aplikuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, rrjedhimisht paragrafi 4, i nenit 71, te LPP-se, shprehimisht potencon: "...Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit". Prandaj pretendimin ankimorë e kualifikojmë si te bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2 (Eksperti teknik) . Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore qe lidhen me specifikacionet teknike te detyrueshme te përcaktuara ne Aneksin 1, te Dosjes se Tenderit, sqarojmë se për Lot 1, "Karrige Gjinekologjike" operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk i plotëson ne tërësi specifikat teknike, konkretisht ne katalogun e prezantuar ne oferte nuk përshkruhet se pajisja posedon, mbulesën e karriges me material antibakterial dhe numri i motorëve, 1,2,3, rrjedhimisht pretendimin ankimore kundrejt lotit 1 e kualifikojmë si te bazuar.

Po ashtu edhe ne Lot 2, "Karrige Stomatologjike", operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie nuk i plotëson ne tërësi specifikacionet teknike te detyrueshme te Aneksit 1, të dosjes se tenderit përkatësisht ne katalogun e prezantuar ne oferte nuk përshkruhen te gjitha specifikat e kërkuara nga

AK – MSH, siç janë "Dental Stool 1 piece" dhe Dental Air Compressor", rrjedhimisht edhe këtë pretendim ankimore e kualifikojmë si te bazuar.
Përderisa lidhur me pretendimin ankimore ku potencohet se OE të propozuar në lotin 1 dhe 2 nuk i kanë nënvizuar produktet e specifikave teknike ne vlerësojmë se mos nënvizimi i tyre nuk e bënë një operator ekonomik të pa përgjegjshme.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/ teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe loti 1 dhe 2 i këtij aktiviteti te prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 05.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues-teknik.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 21.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Pretendimet kryesore ankimore kane te bëjnë kundër arsyetimit te eliminimit ku AK – MSH, përmes letrës standarde te datës 07.09.2020, tekstualisht ka potencuar: "...*OE* "Pro Medical" SH.P.K, është i pa përgjegjshëm, njeri nga anëtaret grupit nuk ka licencën qe është kërkuar "Licenca nga AKPPM, si qarkullues me shumicë i pajisjeve mjekësore".
Parashtruesi i ankesës me datën 14.09.2020, ka paraqitur kërkese për ri shqyrtim duke kontestuar eliminimin mirëpo sipas shkresave te lendes AK/MSH, mirëpo sipas shkresave të lëndës nuk

vërehet se të njëjtit i janë përgjigjur kërkesës për ri shqyrtim. Sipas nenit 108/A, te LPP-se shqyrtimi i kërkesës është i obligueshëm nga AK, andaj pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

Sa i përket arsyes te eliminimit" ...anëtari i grupit nuk ka prezantuar licence nga AKPPM...", paneli shqyrtues vlerëson se kjo pikë e eliminimit nuk qëndron ngase bie ndesh me praktiken dhe rregullat për prokurim publik, përkatësisht me nenin. 71, te LPP-se, pasi qe AK, te njëjtën licence e ka aplikuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, rrjedhimisht paragrafi 4, i nenit 71, te LPP-se, shprehimisht potencon: "...Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit". Andaj duke pasur parasysh këtë fakt, paneli shqyrtues pretendimin ankimor e vlerëson si të bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore qe lidhen me specifikacionet teknike te detyrueshme te përcaktuara ne Aneksin 1, te Dosjes se Tenderit, paneli shqyrtues vlerëson se për Lot 1, "Karrige Gjinekologjike" operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk i plotëson në tërësi specifikat teknike, konkretisht ne katalogun e prezantuar ne oferte nuk përshkruhet se pajisja posedon, mbulesën e karriges me material antibakterial dhe numri i motorëve 1, 2, 3, andaj pretendimin ankimor për lot 1 e kualifikojmë si te bazuar.

Sa i përket Lot 2 "Karrige Stomatologjike", operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie nuk i plotëson ne tërësi specifikacionet teknike te detyrueshme te Aneksit 1, të dosjes se tenderit përkatësisht ne katalogun e prezantuar ne oferte nuk përshkruhen te gjitha specifikat e kërkuara nga AK – MSH, siç janë "Dental Stool 1 piece" dhe Dental Air Compressor", rrjedhimisht edhe këtë pretendim ankimor paneli shqyrtues e vlerëson si te bazuar.

Në lidhje me pretendimin ankimor që OE të rekomanduar për LOT 1 dhe 2 nuk i kanë nënvizuar produktet specifikave teknike, paneli shqyrtues vlerëson se nënvizimi i tyre nuk e bën një operator ekonomik të papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues vlerëson se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit AK nuk ka vepruar konform dispozitave të LPP-së më saktësisht nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave të nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues vlerëson se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Poashtu, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 /AK/ - "Ministria e Shëndetësisë" (M.SH),

1x1 / OE/ - "Pro Medical & Andident"- Ferizaj ,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.